



KPM 2013/01

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2.11 dhe nenit 33 të Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) nr. 04/L-44, KPM nxjerr:

**RREGULLORE**  
**PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË SHËRBIMET**  
**MEDIALE AUDIO-VIZUELE**

**NENI 1**  
**QËLLIMI**

Kjo rregullore ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përbajtjet e programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral apo të zbulojnë identitetin e tyre.

Rregullorja përcakton mënyrën e kategorizimit, sinjalizimit dhe kohën e transmetimit të programeve që ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve. në programe të veçanta që përfshijnë pornografi apo dhunë të panevojshme.

**NENI 2**  
**PËRKUFIZIMET**

1. Termi “*fëmijë*” nënkupton personat që i takojnë moshës deri në 14 vjeç.
2. Termi “*i mitur*” nënkupton personat që i takojnë moshës prej 14 deri 18 vjeç.
3. Termi “kohë e kufizimit” është koha në orarin radio/televiziv që ndan periudhën e lejueshme për të shfaqur program radio/televiziv, që ka përbajtje për të rritur prej periudhës kur nuk është e lejueshme. “Koha e kufizimit” fillon prej orës 24:00 dhe mbaron në orën 05:00. Në shërbimet e parapagimit të cilat nuk janë të mbrojtura me kod, koha e kufizimit është po ashtu prej orës 24:00 deri në ora 05:00.
4. Termi “*dhunë e panevojshme*” nënkupton përdorimin e qëllimshëm të forcës fizike, mekanike dhe forcës tjetër për të dëmtuar, lënduar apo keqtrajtuar.

5. Termi “*frikë*” nënkupton emocionin, shpesh të fuqishëm, që nxitet nga parashikimi përrrezik, të keqe dhe dhimbje, pavarësisht se kërcënimi është real apo imagjinar.
6. Termi “*përbajtje erotike*” u referohet materialeve programore, që përqendrohen tek dëshira seksuale dhe që paraqesin zona të caktuara erogjene të trupit të njeriut dhe synimin final për akt seksual, por nuk i paraqesin personat në mënyrë të qartë gjatë marrëdhënieve seksuale.
7. Termi “*pornografi*” u referohet materialeve programore, të cilat në mënyrë të qartë dhe të hapur paraqesin organet ose aktin seksual të personave.
8. Termi “*programe me përbajtje të dëmshme*” u referohet programeve, të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, dhe moral të fëmijëve.

Programet e pikës 8 përfshijnë, por duke mos u kufizuar vetëm tek këto përbajtje:

- 8.1 Përbajtjet me dhunë fizike, verbale, gjestikulative, emocionale, seksuale ose të përfitaura nëpërmjet efekteve speciale. Dhuna e shfaqur në programe të veçanta artistike duhet të vendoset në kontekst të përbajtjes, të ofrojë mesazhe edukative, të cilat duhet të janë të kuptueshme lehtë si nga fëmijët, ashtu edhe nga publiku i gjerë. Kjo nënkupton që skenat me dhunë të mos janë qëllim.
- 8.2 Përbajtjet me skena seksuale mund të pasqyrohen në kuadër të programeve shkencore, edukative, dokumentar ose informative. Në këto përbajtje duhet të shmangen skenat me shfaqje të tillë seksuale si ekzibicionizmi, nudizmi, dhuna seksuale dhe diskriminimi gjinor. Përbajtjet e tillë vlerësohen në bazë të qëllimit të çdo skene seksuale, duke e vlerësuar përshtatshmërinë e atij qëllimi në raport me moshën e shikuesve.
- 8.3. Përbajtja dhe programi me përbajtje bixhozi, parashikimin e të ardhmes, leximin e letrave, shërbimeve psikike dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht.

### **NENI 3** **KUFIZIMET DHE OBLIGIMET E PËRGJITHSHME**

1. Shërbyesit medial audio-vizuel nuk do të transmetojnë programe me përbajtje të dëmshme përfëmijët, përvçese në kohën dhe kushtet e përcaktuara me këtë rregullore.
2. Shërbyesit medial audio-vizuel, të cilat transmetojnë radio programe me përbajtje të dëmshme përfëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik.
3. Shërbyesit medial audio-vizuel të cilat transmetojnë radio/TV programe me përbajtje të dëmshme përfëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik apo tekstuall dhe t'i identifikojnë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre, sipas kategorizimit të programeve të përcaktuar me këtë rregullore.

4. Shërbyesit medial audio-vizuel mund të transmetojnë programe me përbajtje pornografike vetëm në mënyrë të koduar dhe në pajtueshmëri me nenin 4.1.4 të kësaj Rregulloreje.
5. Në pajtim me këtë Rregullore, shërbyesit medial audio-vizuel duhet të përcaktojnë standarde vetëregulluese (Kodin Praktik) për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët dhe të miturit, si dhe të krijojnë mekanizma të mbikëqyrjes për aplikimin e këtyre standardeve.
6. Pas përpilimit të Kodit Praktik, secili shërbyesi medial audio-vizuel do t'i dërgojë një kopje KPM-së jo më vonë se tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje. Shërbyesit medial audio-vizuel mund ta paraqesin Kodin Praktik në mënyrë individuale apo grupore.
7. Me kërkesë të KPM-së, brenda 3 ditëve të punës, shërbyesit medial audio-vizuel duhet të paraqesin të dhëna të detajuara mbi implementimin e standardeve vetëregulluese të Kodit Praktik.

#### **NENI 4**

#### **MBROJTJA E IDENTITETIT DHE RESPEKTIMI I DINJITETIT TË FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË PROGRAME**

1. Duhet t'i kushtohet kujdes i duhur dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve të cilët janë pjesë ose janë të përfshirë në programe. Kjo rregull duhet të zbatohet pavarësisht nga çdo pajtim që jepet nga prindi, kujdestari ose ndonjë person tjetër mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeçare i cili e përfaqëson të miturin.
2. Nuk do të lejohet publikimi i informatave që zbulojnë identitetin e një fëmije deri në moshën 18 vjeçare i përfshirë në rastet e çfarëdo lloji të dhunës, pavarësisht nga statusi i fëmijës si dëshmitar, viktimë apo autor i krimtit, apo në rastet e tentativës për vetëvrasje apo vetëvrasjeve, si dhe prezantimi i detajeve të çështjeve familjare apo jetës private të një fëmije.
3. Brenda informacionit mbi çdo formë të dhunës dhe rolit të të miturit në të, identiteti i të miturit do të mbrohet gjatë tërë kohës me imazh të hijezuar, të paqartë ose të maskuar dhe me një ton të modular, në mënyrë që i mituri nuk do të identifikohet. Një informacion i tillë nuk do të zbulojë ndonjë detaj të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të fëmijës.
4. Të dhënat personale për të miturit si dhe detajet të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të tyre, nuk do të transmetohen në rastet kur transmetimi i informacionit të tillë mund të dëmtojë mirëqenien e tyre.

#### **NENI 5**

#### **KATEGORIZIMI I PROGRAMeve**

1. **Kategoria e parë** përfshin programet që nuk kanë përbajtje të dëmshme.

2. **Kategoria e dytë** përfshin programet që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 10 vjeçare dhe për të cilat është e domosdoshme prania e prindit ose kujdestarit. Kjo kategori u referohet programeve, që përbajnjë ndonjë skenë dhune ose frike. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse.
3. **Kategoria e tretë** përfshin programet, që përbajnjë skena dhune dhe frike, si dhe përbajtje erotike, të cilat përsëriten relativisht shpesh. Këto përbajtje të dëmshme programore nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 14 vjeçare. Për programet e kategorisë së tretë prania e prindit, kujdestarit, është e domosdoshme. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse.
4. **Kategoria e katërt** përfshin programet, që përbajnjë skena me përbajtje të vazhdueshme dhune të panevojshme, frike si dhe me përbajtje pornografike dhe programe me përbajtje bixhozi, parashikimin e të ardhmes, leximin e letrave, shërbimeve psikike dhe të ngjashme që nuk janë vërtetuar shkencërisht. Këto programe nuk rekomandohen për persona nën moshën 18 vjeçare. Transmetimi i programeve me përbajtje të vazhdueshme dhune dhe frike duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjën përkatëse. Ndërsa, programet me përbajtje pornografike mund të transmetohen vetëm në mënyrë të koduar.

## **NENI 6 KOHA E TRANSMETIMIT**

1. Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së parë nuk i nënshtrohet kufizimeve kohore.
2. Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së dytë mund të bëhet prej orës 15:00 deri në ora 06:00.
3. Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 22:00 deri në ora 06:00.
4. Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së katërt, mund të bëhet prej orës 24:00 deri në orën 05:00. Subjektet transmetuese mund të transmetojnë gjatë kësaj kohe programe me përbajtje pornografike të cilat duhet të janë të koduara.

## **NENI 7 SHENJAT DHE PIKTOGRAMET**

1. Subjektet transmetuese do të përdorin pikogramet të paraqitura në Aneksin 1 të kësaj Rregulloreje.
2. Shenjat e vërejtjes për Kategoritë e përcaktuara me këtë nen janë të detyrueshme për të gjitha programet e përcaktuara në nenin 5 .

3. Para fillimit të programit dhe pas çdo ndërprerjeje tw programit bëhet paralajmërim verbal dhe akustik.

Para fillimit të programit në TV shfaqet shenja paralajmëruese, e cila është kombinim i vërejtjes tekstuale, verbale, akustike dhe vizuale në kohëzgjatje prej 10 sekondave dhe mbulon të paktën  $\frac{1}{4}$  e pjesës së dukshme të ekranit. Formulimi i vërejtjes së shkruar/tekstuale do të jetë: "Programi në vijim nuk është i përshtatshëm për fëmijë dhe të mitur".

Gjatë programit televiziv shfaqet vetëm pjesa vizuale e shenjës në këndin e ekranit, me dimensione minimumi 1/48 dhe maksimumi 1/32.

Programet e Kategorisë së katërt nuk duhet të reklamohen para orës 24:00.

Skema programore e publikuar në teletekst apo shtyp ditor duhet të reflektojë edhe shenjet vizuale për kategorinë përkatëse të programit.

#### **NENI 8 SANKSIONET E APLIKUESHME**

Për mosrespektim të kësaj Rregulloreje do të aplikohen sanksionet e përcaktuara me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

#### **NENI 9 DISPOZITAT KALIMTARE**

Më këtë Rregullore shfuqizohet Rregullorja CIMC 2009/01.

#### **NENI 10 HYRJA NË FUQI**

Rregullorja hyn në fuqi në ditën e nenshkrimit nga Kryetari i Komisionit të Pavarur të Mediave.



Shefki Ukaj  
Kryetar i Komisionit të Pavarur i Mediave

28 maj 2013  
Datë



KPM 2012/01

Shtojca

Kategoria	Klasifikimi	Shenja
Kategoria 1	Nuk do të përcillet me shenjë.	
Kategoria 2	Pëlqimi i prindit/kujdestarit i domosdoshëm ose i ndaluar për moshën deri 10 vjeç.	<b>10+</b>
Kategoria 3	Publik i rritur i ndaluar për moshën deri 14 vjeç.	<b>14+</b>
Kategoria 4	Publik i rritur, i ndaluar për moshën deri 18 vjeç.	<b>18+</b>